



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 644/1 prot.

Shkodër, më 6.10.2023

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 71, datë 28.09.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", neni 56 i ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" i ndryshuar, , të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 29, neni 54, shkronja "dh", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 3, pika 13, neni 22, pika 3, neni 27, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30, shkronja "f" dhe "gj", neni 41, pika 2, të VKM nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile", pika 3.1, shkronja "b", të VKM Nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Kreu III, pika 3, shkresa e AKMC nr. 86/6 prot., datë 27.03.2023 "Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", të shkresës së Këshillit të Bashkiak Vau Dejës nr. 6147 prot., datë 03.10.2023 dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës datë 28.09.2023", shqyrtoi **VKB Vau Dejës Nr. 71, datë 28.09.2023** "Për miratimin e fondit për rikonstruksion i urës paserelë HD 80 ml, në fshatin Mnelë me fondet e akorduara në programin emergjenca civile", me kod produkti 91707AG, "Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve, me vlerë 2.491.106 lekë nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2023".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M  
Nr. 71 datë 28.09. 2023

**Mbi miratimin e objektit “Rikonstruksion i Urës Pasarele HD 80 ml “ në fshatin Mnelë me fondet e akorduara në programin “Emergjencia Civile”**

**Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi nr.3 dt.28.12.2016 “Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave , për vitin 2016, si dhe në shkresën Nr.86/6 dt.27.03.2023 “Mbi fondin e kushtëzuar të Bushetit të shtetit për mbrojtjen civile” si dhe të shkresës së Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr.4234/1 dt.27.03.2023,

Pas diskutimit dhe miratimit me shumice të cilësuar votash,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I:**

- Miratimin** e objektit “Rikonstruksion i Urës pasarel HD 80 ml” në fshatin Mnelë të Njësisë Administrative Vig Mnelë të Bashkisë Vau-Dejës, nga fondi i akorduar për programin e Emergjencave Civile me vlerën **2.491.106.<sup>32</sup>**(dymilion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtë (pikë tridhjetë e dy) lekë e cila është çelur në degën e thesarit me kod produkti **91707 AG** sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.4234/1 dt.27.03.2023.
- Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të familjeve që banojnë në zonën ku ndodhet Ura.
- Burimi i financimit** :Fondi i planifikuar në programin “Emergjenca Civile “sipas shkresës nr.86/6 dt.27.03.2023 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për Mbrojtjen civile” për vitin 2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

4. Ngarkohen : Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësia e Prokurimeve Publike, Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe financës ) për zbatimin e ketij vendimi.
  
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar).

**KRYETAR**

Ervis Shimaj

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Arbën Çelepi

Miratuar me 20 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim 1

Zbardhur me datë 03.10.2023

